



“Goditet një tjetër rast i armëmbajtjes pa leje, falë bashkëpunimit të policisë me qytetarët.

Sekuestrohen 2 armë zjarri dhe 148 fishekë.

Arrestohet në flagrancë poseduesi i tyre.

Në kuadër të bashkëpunimit me qytetarët për të parandaluar dhe goditur paligjshmërinë si dhe në vijim të punës hetimore nga Specialistët e Krimeve në Komisaratin e Policisë Fier është goditur një tjetër rast i armëmbajtjes pa leje.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Fier, në bazë të informacioneve të marra nga qytetarët se një shtetas dispononte armë zjarri në banesë, kanë organizuar punën dhe kanë ushtruar kontroll në banesën e shtetasit T.G, 56 vjeç, banues në Patos.

Si rezultat i kontrollit, policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri automatike me 2 krëhëra, 1 pistoletë me 1 krëhër dhe 148 fishekë.

Në përfundim të veprimeve të kryera, Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisaratin e Policisë Fier bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit T.G për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”.

Materialet procedurale për veprime të mëtejshme do i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.”- njofton policia.

Për t’u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t’ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: arme zjarri fier policia